

## Zhvillohet në Universitetin e Elbasanit takimi mbi projektin COST “CLIL Network for Languages in Education : Towards bi- and multilingual disciplinary literacies”

Nga data 4-6 Mars 2024 u zhvillua në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, takimi i grupit drejtues dhe grupeve të punës të projektit CA21114 - CLIL Network for Languages in Education : Towards bi- and multilingual disciplinary literacies (CLILNetLE), një projekt i COST Association, financuar nga Komisioni EuropeanEU.

Gjatë këtyre ditëve ekspertë të fushës së shumëgjuhësisë nga 16 vende të ndryshme punuan për të përmbushur objektivat e projektit i cili është në vitin e tij të dytë.

Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Humane ka dhënë kontribut të rëndësishëm në kërkimin shkencor si pjesë e këtij COST Action.



